

Republika e Maqedonisë  
Agjencia për përkrahje financiare  
në bujqësi dhe zhvillim rural

Në bazë të nenit 6, paragrafi 5 dhe nenit 12, paragrafi 1, alineja 7 e Ligjit për themelim të Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 72/07, 5/09, 43/14, 193/15, 39/16 dhe 164/18) ndërsa në lidhje me nenin 6, paragrafi 4 të Udhëzimit administrativ për mënyrën dhe procedurën për shfrytëzim të Përkrahjes financiare për masat për zhvillim rural të financuara nga Programi IPARD 2014-2020, drejtori i Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ka sjellë vendimin në vijim:

**VENDIM**

**Për vazhdimin e afatit të Thirrjes publike 01/2018 për parashtrimin e kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga IPARD programi 2014-2020**

Neni 1

Ky vendim ka të bëjë me Thirrjen publike 01/2018 për shfrytëzim të mjeteve nga IPARD Programi 2014-2020.

Neni 2

Afati për parashtrimin e kërkesave vazhdon për 15 ditë.

Neni 3

Ky vendim futet në fuqi me ditën e sjelljes së tij.